

TERMAT E REFERENCËS PËR NJË AUDITIM TË PASQYRAVE FINANCIARE ME OBJEKT NORMAL
AUDITIME TË GRANTEVE DHE TË PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA
PROGRAMI IADSA

(për periudhën e përcaktuar në Shtojcën 1)

Hyrje

1. Audituesi do të auditojë pasqyrat financiare për projektet e financuara nga Programi IADSA, të renditura në Shtojcën 1 të këtyre termave të referencës, për periudhën e përcaktuar në Shtojcën 1.

Objektivi

2. Auditimi i pasqyrave financiare të projekteve ka për objektiv t'i japë mundësi audituesit të shprehë një opinion profesional mbi pozicionin financiar të projektit në mbylljen e periudhës të përcaktuar në Shtojcën 1 dhe mbi të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën kontabël që mbyllet më datën e përcaktuar në Shtojcën 1. Raportet projektit sigurojnë bazën për hartimin e pasqyrave financiare dhe krijohen për të reflektuar veprimet financiare në lidhje me projektin.

Përgjegjësia për hartimin e pasqyrave financiare

3. Drejtuesit e projektit kanë përgjegjësinë për hartimin e pasqyrave financiare, përfshirë edhe mbajtjen e të dhënave adekuate kontabël dhe sistemin e kontrollit të brendshëm, për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël, ruajtjen e aktiveve të projektit dhe dhënien e informacioneve adekuate shpjeguese. Në kuadër të procesit të auditimit, audituesi do t'u kërkojë drejtuesve të projektit konfirmim me shkrim sa u takon përfaqësimeve që na bëhen në lidhje me auditimin.

Objekti

4. Auditimi do të kryhet në përputhje me [Standardet Ndërkombëtare të Auditimit](#) [ose mbështetur në standardet apo praktikat përkatëse kombëtare]. Këto standarde kërkojnë që audituesi të planifikojë dhe të kryejë auditimin, me qëllim që të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë pasaktësi materiale. Auditimi përfshin këqyrjen, në mënyrë testuese, të evidencave që mbështetin vlerat dhe shënimet shpjeguese e pasqyrave financiare. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve kryesore të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.
5. Në përmbushje të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, nga audituesi pritet t'u kushtojë vëmendje në veçanti çështjeve të mëposhtme, përfshirë edhe veçantitë që paraqesin njësitë ekonomike të sektorit publik:
 - (a) Gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit për të ulur riskun e auditimit në një nivel pranueshmërisht të ulët, audituesi duhet të marrë në konsideratë risqet e keqparaqitjeve

materiale në pasqyrat financiare për shkak të mashtrimit, siç e kërkon Standardi Ndërkombëtar për Auditimin 240.

- (b) Gjatë planifikimit dhe kryerjes së procedurave të auditimit dhe gjatë vlerësimit dhe raportimit të rezultateve të tij, audituesi duhet të njohë se mospërputhshmëria e njësisë ekonomike me aktet ligjore dhe nënligjore mund të cenojë në mënyrë materiale pasqyrat financiare, siç e kërkon Standardi Ndërkombëtar për Auditimin 250.
 - (c) Audituesi duhet t'ua komunikojë çështjet e auditimit me interes për drejtimin e brendshëm që lindin nga auditimi i pasqyrave financiare personave përgjegjës për drejtimin e brendshëm të njësisë ekonomike, siç e kërkon Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 260.
 - (d) Audituesi duhet t'ua komunikojë siç duhet personave përgjegjës për drejtimin e brendshëm dhe drejtuesve çdo mangësi të kontrollit të brendshëm të cilën audituesi e ka identifikuar gjatë auditimit të pasqyrave financiare, siç e kërkon Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 265.
 - (e) Për të ulur riskun e auditimit në një nivel pranueshmërisht të ulët, audituesi duhet të përcaktojë mënyrën e reagimit ndaj risqeve të vlerësuara në nivel të pasqyrave financiare, dhe duhet të përcaktojë dhe të kryejë procedura të mëtejshme të auditimit për t'iu përgjigjur risqeve, siç e kërkon Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 330.
 - (f) Kur disa aspekte të caktuara të operacioneve të njësisë ekonomike kryhen nga një ofrues i tretë shërbimesh, nga audituesi pritët të përfshijë një informacion dhe vlerësim të mjedisit të kontrollit të brendshëm të ofruesit të shërbimeve gjatë procesit të auditimit, siç e kërkon Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 402.
 - (g) Në kuadër të procesit të auditimit, nga audituesi pritët të marrë përfaqësime me shkrim nga drejtuesit dhe, sipas rastit, nga personat e ngarkuar me drejtimin e brendshëm, siç e kërkon Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 580.
 - (h) Kur audituesi i jashtëm vendos të përdorë punën e funksionit të auditimit të brendshëm të njësisë ekonomike, me qëllim modifikimin e natyrës ose momentit apo shkurtimin e kohës së procedurave të auditimit që do të kryhen drejtpërdrejt nga audituesi i jashtëm, ky përcaktim bëhet në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit 610.
 - (i) Në marrjen e një vendimi nëse do të përdoret ose jo puna e një eksperti të audituesit apo nëse puna e një eksperti të audituesit është adekuate në kuptim të auditimit, ky vendim bëhet në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit 620.
6. Në marrjen e informacioneve dëshmuese për përputhshmërinë me masat e miratuara për financimin e projektit, nga audituesi pritët të kryejë testime për të konfirmuar se:
- (a) Të gjitha fondet e jashtme janë përdorur në përputhje me kushtet e marrëveshjeve përkatëse të financimit, duke i kushtuar vëmendjen e duhur ekonomisë dhe efikasitetit, dhe vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë financimi.
 - (b) Fondet e kundërpalës janë vënë në dispozicion dhe janë përdorur në përputhje me marrëveshjet përkatëse të financimit, duke i kushtuar vëmendjen e duhur ekonomisë dhe efikasitetit, dhe vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë financimi.

- (c) Janë mbajtur të gjitha dokumentet mbështetëse, evidencat dhe llogaritë në lidhje me të gjitha aktivitetet e projektit, përfshirë shpenzimet e raportuara duke përdorur metodën e raportimit me pasqyra të shpenzimeve apo pasqyra të ndërmjetme të paaudituarra financiare. Nga audituesi pritet të verifikojë se raportet përkatëse të nxjerra gjatë periudhës kanë qenë në përputhje me librat bazë të llogarive.

Pasqyrat financiare të projektit

7. Audituesi duhet të verifikojë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me [Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik](#). Në pasqyrat financiare duhet të jenë përfshirë:
- (a) Një përmbledhje e shpenzimeve të paguara, të paraqitura sipas titujve të llogarive të projektit dhe sipas kategorive kryesore të shpenzimeve; dhe
 - (b) Informacione të tjera shpjeguese në formën e shënimeve shpjeguese, përfshirë hollësi të pasqyrave të shpenzimeve në mbështetje të Kërkesave për Tërheqje të dorëzuara gjatë periudhës, një rakordim të lëvizjeve në Llogarinë e Përcaktuar dhe një pasqyrë të tepricave të fondit.
 - (c) Kur njësi ekonomike e vendos publikisht në dispozicion buxhetin e saj të miratuar, një krahasim të shumave plan-fakt, ose si pasqyrë financiare më vete, ose si shtyllë buxheti në pasqyrat financiare; dhe
 - (d) Shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënime të tjera shpjeguese.

Shqyrtimi i pasqyrave të shpenzimeve dhe i pasqyrave të pasqyrave të ndërmjetme të paaudituarra financiare

8. Audituesit i kërkohet të auditojë të gjitha pasqyrat financiare/raportet periodike financiare që i paraqiten Njesisë Teknike Mbështetëse të Programit IADSA në mbështetje të kërkesave për rimbushjen e fondeve të llogarisë apo llogarive të përcaktuara të projekteve. Shpenzimet duhen këqyrur për të verifikuar pranueshmërinë në bazë të kriterëve të përcaktuara në kushtet e marrëveshjes së financimit dhe të detajuara në dokumentin e vlerësimit të projektit. Audituesi duhet të raportojë çdo shpenzim të palejuar të cilin e identifikon se është përfshirë në kërkesat për tërheqje të fondeve dhe është rimbursuar.

Shqyrtimi i llogarive të përcaktuara

9. Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të projektit, audituesit i kërkohet të shqyrtojë aktivitetet e llogarisë/llogarive të përcaktuara të projektit. Në aktivitetet që duhen këqyrur përfshihen derdhjet e fondeve në llogari, pagesat e bëra nga llogaria, interesi i fituar dhe rakordimi i tepricave në mbyllje të periudhës.

Raportet e auditimit

Opinionit i auditimit

10. Audituesi do të japë një opinion auditimi mbi pasqyrat financiare. Opinioni i audituesit bazohet në një vlerësim të përfundimeve të nxjerra nga evidencat e përfthuara të auditimit dhe shprehet qartë me anë të një raporti me shkrim i cili përshkruan edhe bazën e opinionit. Raporti i auditimit hartohet në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit 700.
11. Një opinion i modifikuar auditimi jepet në pasqyrat financiare kur audituesi arrin në përfundimin, në bazë të evidencave të përfthuara të auditimit, se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë keqparaqitje materiale; ose audituesi nuk është në gjendje të përftojë evidenca të mjaftueshme e të duhura auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keqparaqitje materiale. Opinionet e modifikuara të auditimit duhet të jenë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit 705.
12. Audituesi do të përfshijë paragrafë për theksim çështjeje ose paragrafë për çështje të tjera në opinionin e auditimit kur audituesi, pasi ka krijuar një opinion mbi pasqyrat financiare, kërkon t'u tërheqë vëmendjen përdoruesve, kur sipas gjykimit të audituesit është e nevojshme një gjë e tillë, me anë të një komunikimi të qartë shtesë në raportin e audituesit. Paragrafët mund ta drejtojnë vëmendjen e lexuesit ose të një çështjeje e cila, paçka se është paraqitur apo shpjeguar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare, ka një rëndësi të atillë që është themelore për të kuptuarit e pasqyrave financiare nga ana e përdoruesve; ose sipas rastit, të ndonjë çështjeje tjetër e cila është me rëndësi për të kuptuarit e auditimit, përgjegjësi të auditimit apo raportit të audituesit nga ana e përdoruesve. Forma e opinionit do të paraqitet në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit 706.

Raporte të tjera të auditimit

13. Krahas opinionit të auditimit, audituesi, ose në raportin e auditimit, ose në raportin për drejtuesit:
 - (a) jep komente dhe vërejtje mbi evidencat kontabël, sistemet dhe masat e kontrollit të cilat janë marrë në këqyrje gjatë kryerjes së auditimit;
 - (b) identifikon mangësi specifike dhe fusha me dobësi në sistemet dhe masat e kontrollit dhe jep rekomandime për përmirësimin e tyre;
 - (c) raporton për rastet e mospërputhshmërisë me kushtet e marrëveshjes financiare;
 - (d) shpreh në mënyrë sasiore dhe raporton shpenzimet të cilat konsiderohen se janë të palejuara dhe ose janë paguar nga llogaria e përcaktuar ose janë kërkuar të rimbursohen nga ana e Njësisë Teknike Mbështetëse të Programit IADSA;
 - (e) komunikon çështjet për të cilat kanë ardhur në dijeni gjatë kryerjes së auditimit dhe të cilat mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në zbatimin e projektit;
 - (f) përfshin përgjigjet nga drejtuesit, përfshirë edhe masat e zbatuara apo të propozuara korrigjuese.

14. Nëse, gjatë kryerjes së auditimit, audituesi nuk ka ardhur në dijeni të asnjë çështjeje të cilën do ta kishte quajtur me rëndësi për t'u sjellë në vëmendje dhe, për këtë arsye, nuk hartohet një letër për drejtuesit, audituesi lëshon një letër ku thuhet një gjë e tillë.

Të përgjithshme

15. Audituesi ka të drejtë konsultimi të pakufizuar në të gjitha informacionet dhe shpjegimet e konsideruara të nevojshme për të ndihmuar auditimin, përfshirë dokumentet ligjore, raportet e përgatitjes dhe të mbikëqyrjes së projektit, raportet e shqyrtimeve dhe të hetimeve, korrespondencën dhe informacionet për llogarinë e kredisë. Audituesi mund të kërkojë edhe konfirmim me shkrim të vlerave të lëvruara dhe në pritje, siç janë të mbajtura në evidencat e përfituesve të financimit.
16. Audituesi nxitet të takohet dhe të diskutojë për çështje të lidhura me auditimin, përfshirë edhe të dhënat e nevojshme për planin e auditimit, me ekipin përgjegjës për projektin pranë Programit IADSA.
17. Nëse emërimi i audituesve do të ishte për më shumë se një vit, mund të shtohet një paragraf në rubrikën ***“Të përgjithshme”***, në fund fare të Termave të Referencës, si vijon: *“Ky mandat angazhimi mbetet në fuqi për vitet e ardhshme fiskale nëse nuk përfundohet, ndryshohet apo zëvendësohet.*